




REPUBLIKA E SHQIPËRISË



## VENDIM

Nr.07, datë: 09.04.2024



### PËR PROPOZIMIN PËR DHËNIE SHITESË PENSIONI TË POSAÇËM SHTETËROR

Këshilli i Qarkut Shkodër i mbledhur sot më datë 09.04.2024, pasi mori në shqyrtim relacionin mbi projekt vendimin "Për propozimin për dhënie shtesë pensioni të posaçëm shtetëror", të përgatitur nga administrata dhe Kryetari i Këshillit të Qarkut, mbështetur në Ligjin Nr. 139/2015, datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore", në Ligjin Nr. 7703, datë 11.05.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë" (i ndryshuar), në VKM-në Nr. 429, datë 12.09.2002 "Për kushtet e përfitimit, shumën dhe procedurën e dhënies së pensioneve të posaçme shtetërore dhe shtesave të pensioneve të posaçme shtetërore"; nenit 5, kërkesën e subjektit, si dhe bazuar në Rregulloren për Organizimin dhe Funksionimin e këshillit të Qarkut Shkodër, konkretisht neni 12,13, dhe 15.

Pas relativitetit nga zyra e drejtorisë së zhvillimit dhe bashkepunimit me jashtë dhe më pas diskutimit nga anëtarët e këshillit u kalua në procesin e votimit të fshehtë ku u Miratua me 17 Vota **Pro**, 0 Vota **Kunder**.

Në përfundim Këshilli i Qarkut Shkodër

### VENDOSI:

- I. T'i propozojë Këshillit të Ministrave dhënien e shtesës së pensionit të posaçëm shtetëror për, **znj. Zhaneta Brahim Miloti**
- II. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi Administrata e Këshillit të Qarkut Shkodër.
- III. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 3 të nenit 78 të Ligjit Nr. 139/2015

K RYETARI

Edmond NDOU

